

Fakte mbi dhunën në familje

Dhuna në familje nuk është një çështje private që i përket vetëm familjes. Ajo është në kundërshtim me ligjin. Dhuna në familje ndodh në të gjitha klasat shoqërore dhe udhëhiqet nga nevoja për të pasur pushtet dhe kontroll ndaj një personi tjetër.

Dhuna në familje përfshin sulmet fizike, si rrahjet, goditjet me grusht, shkelmimet, marrëdhëniet seksuale me dhunë, sulmet me armë dhe izolimi me dhunë. Ajo përfshin edhe abuzimin emocional ku bëjnë pjesë sulmet verbale (si bërtitjet, sharjet), izolimin nga shoqëria, frikësimin, kanosjet për dhunë apo për marrje të fëmijëve. Jo më pak i rëndësishëm është edhe abuzimi ekonomik, përfshirë vjedhjen e partnerit, mosdhënien e parave të domosdoshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor, shfrytëzimin e një personi për përfitime financiare apo pengimin e partnerit që të punojë.

Roli ynë kundër dhunës në familje

ROLI YNË NË SHOQËRI

Bisedo më miqtë e të afërmit e tu mbi këtë fenomen. Ndaj mendimet e tua për t'iu kundërvënë dhunës në familje. Askush nuk meriton të trajtohet keq, aq më tepër në një mjedis familjar ku secili prej nesh duhet të ndihet i mbrojtur.

KUR NUK DUHET TË HESHTIM

Reago dhe mos hesht kur dëgjon një rast të dhunës në familje. Ndihma jote mund të shpëtojë jetë. Denonco rastet e dhunës në familje kur bëhesh dëshmitar i tyre. Mos u trojë indiferent!

SI MUND TA NDIHMOJMË NJË PERSON TË DHUNUAR

Shpesh njerëzit ua vënë fajin të dhunuarve si shkaktarë të dhunës, por kjo nuk është aspak e drejtë. Faji nuk është i viktimës! Cilatdo qofshin rrethanat, dhuna nuk mund të legjitimohet. Askush nuk duhet të dhunohet!

ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE

Shoqata "Refleksione"

Rr. e Elbasanit, Pallatet "Fratari",
Tërshana 2, Kati I, Shk.2,
Kutia Postare 2412/1, Tiranë
Tel./faks: (04) 2340434
refleksione@icc-al.org

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Adresa: Rr. "Sami Frashëri",
Pall.9, Shk.5, Kutia Postare 2416/1,
Tiranë
Tel.: (04) 2233408
qkgv@albn.net

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Rr. "Vaso Pasha", Pall.12, Shk.1,
Ap.1, Tiranë
Tel./faks: (04) 2259795
avokatore@albnmail.com,
aurboz@yahoo.com

Qendra e të Drejtave të Njeriut në Demokraci

Kutia Postare 2901, Tiranë
Tel./faks: (04) 2400712
qnd@albaniaonline.net;
info@hrdc.al

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Rr. "Abdyl Frashëri", Pall. 10, Tiranë
Tel.: (04) 2255514
gadc@gadc.org.al

Qendra Sociale për Gra dhe Vajza

Lagjia 11, Rr. "Baki Çelmeta", pranë
Restorantit "Pranvera", Durrës
Tel./faks: (052) 2223815
shoqataegrave@yahoo.com

Gruaja te Gruaja

Rr. "Marlin Barleti", sipër Kristallit,
përballë kinemasë "Millennium",
Shkodër
Tel.: (022) 241154, (022) 245234
grujatekgruaja@gmail.com

Qendra e Gruas "Hapat e Lehtë"

Rr. "Branko Kadia",
Lagjia "3 Heronjtë", Nr.57, Shkodër
Tel.: (022) 241316
qendragruashk@yahoo.com

The Door"

Lagjia "Naim Gjylbegu"
Rruga "Bujar Bishanaku", Shkodër
Tel.: (022) 2243729
thedoora@infothedoora.com

Qendra e Grave "Kristal"

Pallati i Kulturës "Margarita
Tutulani",
Kati i parë, Berat
Tel.: (032) 231 004
qkgv@yahoo.com

Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare

Lagjia "Llukan Prifti", Kuçovë
Celular 0692296445
teftangsk@yahoo.com

Forumi i Gruas Elbasan

Lagjia "5 Maji", Rr. "Fetah Ekme-
ciu", Pall.450/1, Elbasan
Tel./Faks: (054) 255509, 2540051
forumi_gruaselbasan@yahoo.com

Shoqata "Unë Gruaja"

Rr. "Rreshit Çollaku", Pogradec
Tel.: (083) 222140, Faks: (083)
225104
une_grujaja@yahoo.com

STREHËZA PËR GRATË

Strehëza për Gra dhe Vajza, Tiranë

Tel.: (04) 2261885

Qendra "Vatra"

Tel./faks: (033) 224078,
(033) 228048
qvatra@icc-al.org

Tjetër Vizion

Tel./faks: (054) 259657

Qendra Komunitare, Gjirokastrë

Tel.: (084) 268866,
Cel. 0692059427
idrizi_bardha@yahoo.com

osce

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



Mos Hesht!

9 nga 10 gra nuk e denoncojnë dhunën

129



Si të kërkoj mbrojtje nga dhuna në familje?

Nëse mëson se dikush ka nevojë për ndihmë të menjëhershme apo je vetë në ato kushte, mund të trokasësh në disa dyer. Mund t'i drejtohesh komisariatit më të afërt të policisë të vendit ku banon apo ku ndodhesh, njësisë së pushtetit vendor, ose qendrës më të afërt shëndetësore. Pranë çdo bashkie, përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale shërben si koordinator vendor për dhunën në familje. Ai, së bashku me një ekip profesionistësh, mbledhen për të ndjekur nga afër rastin tënd dhe për të plotësuar nevojat e tua. Koordinatori të ndihmon jo vetëm të përgatisësh dhe paraqitësh kërkesat për urdhra mbrojtës, por edhe të shoqëron në gjykatë, polici apo për shërbime të tjera të domosdoshme. Mos ki frikë për të dhënat e tua. Ato trajtohen me kujdes dhe fshehtësi nga çdo punonjës apo autoritet që të vjen në ndihmë.

KUJT T'I TELEFONOJ PËR NDIHMË?

- ☎ Policisë
- ☎ Urgjencës
- ☎ Linjës kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza 08004020
- ☎ Rrjetit të Qendrave për Zhvillim Komunitar
- ☎ "Sot për të ardhmen" 08009888
- ☎ Linjës së Këshillimit për Fëmijë 116
- ☎ Shërbimeve në Bashkitë e rretheve:
- ☎ Bashkia Shkodër 02241316
- ☎ Bashkia Korçë 08003434
- ☎ Bashkia Pogradec 083226927
- ☎ Bashkia Fier 034410700
- ☎ Bashkia Burrel 021723536
- ☎ Bashkia Lushnjë 08002325/035226008
- ☎ Bashkia Tiranë dhe Durrës 08009888

Mund t'i telefonosh edhe organizatave jofitimprurëse që japin ndihmë për viktimat e dhunës në familje (shih listën në fund)

SI TË MBROHEM NËPËRMJET NJË URDHRI MBROJTËS?

Një urdhër i zakonshëm mbrojtjeje është një vendim gjykate që e detyron dhunuesin të mos vazhdojë cënimin ndaj teje apo anëtarëve të familjes tënde. Nëse ndodhesh në rrezik të menjëhershëm nga dhuna, gjykata mund të lëshojë një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje brenda 48 orëve nga kërkesa jote, kur je madhor, dhe brenda 24 orëve, nëse je i mitur. Ky është një urdhër i përkohshëm, i cili vlen derisa të lëshohet një urdhër i zakonshëm, brenda 20 ditëve. Thyerja e urdhrit përbën vepër penale.

Urdhri mbrojtës e detyron dhunuesin të kryejë apo të mos kryejë veprime të caktuara. Për shembull, një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje mund ta urdhërojë dhunuesin të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose komunikojë me ty apo me anëtarët e familjes përmes telefonit, postës, postës elektronike apo përmes një pale të tretë. Urdhri mund ta largojë dhunuesin nga banesa. Mund të kërkosht një urdhër mbrojtjeje duke paraqitur një kërkesë-padi në çdo gjykatë civile.

Gjykatat e rrethit punojnë nga e hëna në të premte, 08.00-16.00.

SI TA BIND GJYKATËN QË JAM DHUNUAR?

Për të bindur gjyqtarin se ka pasur me të vërtetë dhunë, duhet të japësh sa më shumë detaje, duke përfshirë datën dhe vendin e incidentit, llojin e dëmtimeve fizike dhe emrat e dëshmitarëve të mundshëm. Bëj fotografi të plagëve të shkaktuara nga dhuna dhe merri të gjitha me vete në seancë gjyqësore.

Dorëzo edhe raportet e policisë dhe të mjekut mbi gjitha incidentet (të ndodhura më parë apo së fundmi), si dhe ndonjë urdhër të mëparshëm mbrojtjeje dhe urdhër arresti.

Kur merr trajtim mjekësor për plagët, sigurohu t'i thuash mjekut që të shkruajë ato që kanë ndodhur, duke i dhënë edhe emrin e dhunuesit.

A MUND TË NIS PROCEDIM PENAL KUNDËR DHUNUESIT?

Po, mundesh. Gjithashtu, mund të bësh edhe kallëzim penal kur:

- Dhunuesi, edhe pse në marrëdhënie familjare ose bashkëjetese me ty, të rreh, të plagos apo kryen veprime të tjera të dhunshme, që sjellin si pasojë cënimin e integritetit tënd fizik, psiko-social dhe ekonomik;
- Dhunuesi të kanos seriozisht për vrasje ose plagosje të rëndë me pasojë cenimin e integritetit tënd fizik, psiko-social dhe ekonomik;



- Bashkëshorti apo bashkëjetuesi yt kryen marrëdhënie seksuale me ty pa pëlqimin tënd apo të shtyn për të ushtruar prostitucion;
- Dhunuesi të kërcënon ose ngacmon me anë të veprimeve të përsëritura me qëllim që të të shkaktojë një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike, duke vënë në rrezik kështu sigurinë tënde, të një të afërmi apo të një personi, me të cilin ke lidhje shpirtërore, apo edhe për të të detyruar të ndryshosh mënyrën tuaj të jetesës;
- I mituri është keqtrajtuar fizikisht ose psikologjikisht nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor apo personi që është i detyruar të kujdeset për të.